

PJESA E DYTE

PESEDHJETORJA

E DIELA E SHENJTE E PASHKES SE MADHE

Kjo shërbesë bëhet të Shtunën e Madhe në mes të natës më të gëdhirë e Diela. Passi bekon Prifti, thuhet Trishenjtë, Psalmi 51 pa zë, dhe pastaj këndohet Kanuni i Epitafisë më gjashtë me Vargun pasonjës:

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

Pastaj këndohet në Alltar Trishenjtë, Përlëshorja e Tingëllit II, Litanja e Gjerë dhe Prifti bën Përlëshimin e Vogël:

PRIFTI. Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, me nërmjetimet e Shën Marisë dhe të gjithë Shenjtorëve, na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si i mirë dhe njeridashës.

Pastaj shuhen të gjitha dritët e Kishës përveç atyre të Shenjtërores, edhe Prifti del me një llambadhe të ndezur, dyke kënduar më Tingëllin Tërthor I:

DHEFTE LLAVETE FOS

Merrni dritë këtu, se kjo dritë s' ka perëndim; lavdëroni Zotin Krisht, se sot u-ngjall së vdekurësh.

Vallet e përsëritin nga një herë, dhe në këtë mes besnikët i ndezin llambadhet. Pastaj klerikët edhe populli dalin jashtë Kishës. Vallet këndojnë më Tingëllin Tërthor II:

TIN ANASTASIN SU

Ngjalljen tënde të Shenjtë o Zoti Krisht, Engjëjt' e hymnojnë me brohori; vlerësona edhe ne përmirë dhenë sot, të të këndojmë me zëmër të paqme.

Passi arrijnë në platformën e pregatitur jashtë Kishës, Prifti këndon Ungjillin Mëngjedor II ose Ungjillin e së Shtunes se Madhe:

DHJAKU: Dhe që të vlerësohemi ta dëgjojmë Ungjillin e Shenjtë, Zotit Perëndisë tonë le t'i lutemi.

KORI: Mëshiro, o Zot. (3 herë)

DHJAKU: Urtësi, o të drejtë. Le ta dëgjojmë Ungjillin e Shenjtë.

PRIFTI: Paqe të gjithëve.

KORI: Dhe me frymën tënde.

DHJAKU: Këndimi prej Ungjillit të Shenjtë pas Markut.

PRIFTI: Le të vemë re.

Pastaj Prifti këndon Ungjillin:

UNGJILLI PAS MARKUT

Passi shkoj e Shtuna, Maria Madalena, dhe Maria e Jakobit, edhe Salloma kishin blerë aroma që të vinin edhe ta lyenin trupin e Jesujt. Edhe shumë menatë, më të lindur dielli, ditën e parë të javës, po venin në varrin, dhe po thoshin me veten e tyre: "Kush do na e rrugullizë gurin prej derës së varrit?" Edhe kur ngritnë sytë, panë se guri ishte rrugullizur; edhe guri ishte fort i math. Edhe kur hynë brënda në varrin, panë një djalosh, te veshur me një stoli të bardhë, që rrinte më të djathtë, edhe u-çuditnë. Po ay u tha: "Mos u-çuditni. Kërkoni Jesunë e kryqësuar prej Nazaretit; u-ngjall, nuk është këtu; ja vëndi, ku e kishin vënë. Po ecëni, dhe u thoni dishepujve te tij dhe Pjetrit që shkoj edhe ju pret në Galile; atje do

ta shikoni, sikundër ju ka thënë.” Dhe ato dualinë me vrap, edhe iknë nga varri; edhe ishin të trëmbura dhe të habitura, dhe nuk i thanë njeriu gjësendi, se kishin frikë.

KORI. Lavdi më ty, o Zot, lavdi më ty.

Në vëndin e Ungjillit të sipërmë, munt të këndohet Ungjilli pasonjës:

UNgjILLI PAS MATTHEUT

Edhe si shkoj e Shtuna kur po gëdhihej dita e parë e javës, Maria Madalena dhe Maria tjetër arthnë për të shikuar varrin. Edhe ja ku u-bë një tërmet i math. Se Engjëlli i Zotit zbriti prej qjellit, edhe e rrugullizi gurin nga dera e varrit, edhe rrinte mi atë. Edhe pamja e tij ishte si vetëtimë, edhe roba e tij ishte e bardhë si dëborë. Edhe ruajtësit u-drothnë nga frika, dhe u-bënë si të vdekur. Edhe Engjëlli u tha grave: “Mos kini frikë; se e di që kërkoni Jesunë e kryqësuar. Nuk është këtu, se e u-ngjall, sikundër tha. Ejani, shikojeni vëndin, ku dergjej Zoti. Edhe shkoni shpejt, edhe u thoni dishepujvë që u-ngjall prej së vdekurësh, edhe ja ku ju pret në Galile; atje do ta shikoni; ja ku jua thashë.” Edhe ato dualinë me vrap nga varri me frikë dhe me gas të math, edhe rentnë për të lajmëruar dishepujtë. Edhe tek po shkonin, t’i lajmëronin dishepujtë, ja ku i hasi Jesuj, edhe u tha: “Gëzohuni.” Edhe ato iu-afruan, edhe i ranë në këmbë, dhe iu-falnë. Edhe Jesuj u tha: “Mos kini frikë; shkoni edhe lajmërojini vëllezërit e mi te shkojnë në Galile, dhe atje do më shohin.”

Edhe tek po shkonin ato, ja disa prej kustodisë arthnë në qytet, edhe u treguan Kryepriiftinjtë të gjitha ato, oë kishin ngjarë. Edhe ata, passi u-mblothnë dhe u-këshilluan me pleqtë, u dhanë ushtarëve shumë argjende,

dhe u thanë: “Thoni se dishepujtë e tij arthnë natën, dhe e votnë, kur ne po flinim. Edhe nëqoftëse e dëgjon guvernori, ne do ta bindim, dhe do ta ujdism punën tuaj.” Kështu ata i muarnë argjëndet, edhe bënë ashtu, siç u-mësuan. Edhe kjo fjalë është përhapur midis Judenjve gjer më sot.

Edhe të njëmbëdhjetë dishepujtë vajtin në Galile, në malin ku i kishte porrositur Jesuj. Dhe kur e panë, iu-falnë, po ca dyshuan. Dhe u-afrua Jesuj, dhe u foli dyke thënë: “Më është dhënë e tërë fuqia mi qjellin edhe mi dhenë. Ecëni, pra, dhe nxënësojini gjithë kombet, dyke i pagëzuar më emrin e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, edhe dyke i mësuar t’i ruajnë të gjitha ato, që ju porrosita. Dhe ja, unë do të jem bashkë me ju gjithë ditët gjer në mbarimin e jetës.” Amin.

Pastaj Priifti thotë me zë të lartë:

PRIFTI: Lavdi Trinisë së Shenjtë, së bashkëqënshime, dhe së pandarë, gjithënjë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

Pastaj Priifti këndon tri herë Troparin e Pashkës:

KHRISTOS ANESTI, T. T. I.

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve një jet’ u dhuroj të re. (3 herë)

Pastaj Kori këndon Troparin e Pashkës gjashtë herë me Vargjet pasonjëse, të cilat i thotë Priifti përpara Troparit:

PRIFTI: Le të ngrihet Perëndia, dhe le të përnda-

hen armiqtë e tij, dhe le të ikin prej faqes së tij ata që i kanë mëri.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

PRIFTI: Do të humbasin si tymi në erë; do të shkrijnë si dylla përpara zjarrit.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

PRIFTI: Ashtu do të humbasin mëkatarët nga faqja e Perëndisë, edhe të drejtët do të dëfrenë.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

PRIFTI: Kjo është dita që ka bërë Zoti; le të ngazëllohem dhe le të dëfrenë n' atë.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

PRIFTI: Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

PRIFTI: Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

KORI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje

vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

Pastaj Prifti e këndon Troparin e Pashkës një herë:

PRIFTI: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen kyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re.

Pastaj thuhet Litanja e Madhe, dhe pas kësaj klerikët edhe populli kthehen prapë në Kishë, edhe këndohet Kanuni i Pashkës më gjashtë me këtë Vark:

Lavdi Ngjalljes sate së Shenjtë, o Zot lavdi më ty.

KANUNI I PASHKES, T. I.

ANASTASEOS IMERA

KENGA I.

Dit' e Ngjalljes sot na ndriti, ngazëllohuni pra, Pashka e Zotit Pashka, se ja prej vdekjes në gëzim, dhe prej dheut lart në qjell, na shpuri me këngë mundëse Zoti Krisht, Shpëtimtari i shpërve. (2 herë)

Le t'i zgjojmë ndjenjat tona, që ta shohim me sy, dritën e paafruar, Jesun' i cili shkrepëtin dhe me gas na përshëndosh, si Gratë në varr me fjalën Gëzohuni, Shpëtimtar' i triumfeve. (2 herë)

Ngazëllohu ti o qiell, dhe dëfre ti o dhe, ejani që të gjithë, dhe krentëroni me gëzim, ju o njerës përmi dhe, me Engjëjtë se u-ngjall dhe na dha Jesuj, ngazëllimin e jetëve.

ZBRITESORJA I.

Dit' e Ngjalljes sot na ndriti, ngazëllohuni pra

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. (3 herë)

Kur u-ngrit Jesuj prej varrit i tridiçim siç tha më parë, jetë na dhuroj, të pasosur lart në qjell dhe përdëllim të math.

Pastaj Litaniam e Vogël:

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri. . . .

PRIFTI: Se jotja është madhështia, edhe jotja është Mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KENGA III

Eni pini uje krejt të re, që s' e nxori prej shkëmbit, shkopi çuditërisht, po që buron si rrëke, nga varri i Zotit Krisht, që jetën na shiguron. (2 herë)

Sot me dritë bota po shkëlqen, qjell' i tërë me dhenë, dhe i nënëdhemi Ferr; le ta kremtojmë pra tok, të kremten e Zotit Jesu Krisht, që jetën na shiguron. (2 herë)

Die hyra tok me ty në varr, edhe sot që u-ngjalle, u-ngrita tok me ty; mi Kryqin vojta me ty, dhe ti pra tani më lavdëro, në qjellin si Mbret dhe Zot.

ZBRITESORJA III

Eni pini uje krejt të re, që s' e nxori prej shkëmbit. . . .

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen

dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. (3 herë)

Kur u-ngrit Jesuj prej varrit i tridiçim siç tha më parë, jetë na dhuroj, të pasosur lart në qjell dhe përdëllim të math.

Pastaj Litaniam e Vogël:

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri. . . .

PRIFTI: Se ti je Perëndia ynë, dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

DEGJIMI, T. IV.

Kur arthnë Gratë me Marinë përpara agimit, edhe e gjetnë gurin të rrugullizur, Engjëlli u tha: Si e kërkoni si njeri me të vdekurit, atë që rron në dritën e ameshuar? Rentni dhe lëçitini botës, që Zoti u-ngrit, edhe e vrau vdekjen, se është i Biri i Perëndisë, që shpëtoj gjindjen e njerësve.

KENGA IV

Nga fron' i qjellit o Profet, Perëndifolës Abakum, eja sot me ne dhe tregona, dritën edhe Engjëllin, i cili sheshit lajmëron: Sot i ka ardhur botës shpëtimi, se Jesu Krishti u-ngjall, si Zot dhe Perëndi. (2 herë)

I pari djal' i pari Bir, i Virgjëreshës Shën Mari, ishte si njeri Jesu Krishti, përandaq u-qua qenq, se ishte i panjollëshmë, dhe na dhuroj të kremten e Pashkës, si Perëndi dhe Zot i gjithë botëve.

Si i pafajmë qenq për mot, u-suall Krishti mi alltar, dhe vullnetarisht me kurorë, për të gjithë ne u-ther, si Pashkë shenjtëronjëse, dhe përsëri prej varrit i bukur,

prapë na ndriti me gas dielli Zoti Krisht.

David' i Shenjtë dhe Hyjprind, rreth arkës hidhej me gëzim, dhe me lavdërim po këcente, edhe ne me popullin, me çfaqjen e simboleve, le ta krentojmë ditën e Pashkës, se Jesu Krishti u-ngjall si Perëndi dhe Zot.

ZBRITESORJA IV.

Nga fron' i qjellit o Profet, Perëndifolës Abakum. . .

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. **(3 herë)**

Kur u-ngrit Jesuj prej varrit i tridiçim siç tha më parë, jetë na dhuroj, të pasosur lart në qjell dhe përdëllim të math.

Pastaj thuhet Litania e Vogël:

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri, më paqe le t'i lutemi Zotit. . . .

PRIFTI: Se ti je Perëndi i mirë dhe njeridashës, dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KENGA V

Mëngoni menatë dhe eni, dhe le t'i shpiem këndime, si myrrë Zotit në varrin, që ta shohim Zotin Krisht, që na fal si dielli, jetën dhe paqen të gjithëve. **(2 herë)**

Kur panë mëshirën e madhe, ata që ishin në Ferrin, të robëruar për jetë, me gëzim nxitohëshin, për të shikuar dellin, ditën e Pashkës së Zotit Krisht. **(2 herë)**

Ndisni llambadhet e dilni, prisni Jesunë që dolli,

prej varrit si prej një dasme, dhe le ta krentojmë tok, me botën e besnikëve, Pashkën e Shenjtë shpëtonjëse.

ZBRITESORJA V.

Mëngoni menatë dhe eni, dhe le t'i shpiem këndime.

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. **(3 herë)**

Kur u-ngrit Jesuj prej varrit i tridiçim siç tha më parë, jetë na dhuroj, të pasosur lart në qjell dhe përdëllim të math.

Pastaj thuhet Litania e Vogël:

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri, më paqe le t'i lutemi Zotit. . . .

PRIFTI: Se është i shenjtë dhe i lavdëruar emri yt i nderçim edhe madhështor, i Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KENGA VI

Kur zbrite gjer në funt të dheut në Ferr, dhe dërmovë gjithë llozet e burgut, çlirove të gjithë skllëvët o Krisht, edhe pas tri ditsh, prej balenës si Jonaj, dolle jashtë nga varri. **(2 herë)**

Pa ngarë vulën Zoti Jesu Krisht, dolle jashtë varrit ti që ke lindur, prej Nënës dhe Virgjëreshës Mari, edhe dyertë, e Parajsës lart në qjell, për të gjithë i hape. **(2 herë)**

Blatove veten dyke dashur për kurban, mi alltarin.

dhe u-there për botën, o Zoti ynë Jesu Perëndi, edhe ngrite sot, njerëzinë në qjell, kur u-ngjalle prej varrit.

ZBRITESORJA VI

Kur zbrite gjer në funt të dheut në Ferr. . . .

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. **(3 herë)**

Kur u-ngrit Jesuj prej varrit i tridijim siç tha më parë, jetë na dhuroj, të pasosur lart në qjell dhe përdëllim të math.

Pastaj thuhet Litanja e Vogël:

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri. . . .

PRIFTI: Se ti je Mbreti i paqes dhe Shpëtimtari i shpirteve tona, dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

SHKURTORJA, T. T. IV

I KE EN TAFO KATILTHES

O i pavdekur që zbrite në varr për ne, dhe e dërmovë Skëterrën o Zot përdhe, dhe u-ngjalle si fitimtar o Krisht Perëndi, edhe Grave me myrra u thirre Gëzohuni, dhe u dhurove paqen e qjellit dishepujve, ti që u fale Ngjalljen të rënëve.

SHTEPIA

Diellin përpara diellit, që perëndoj një herë në varr, dyke mënguar që menatë, vajtin ta kërkonin si ditë Vajzat Myrrëprurëse, dhe i thërrisnin njëjatrës: Eni, o miqesha, ta lyejmë me aroma trupin jetëprurës të varro-

sur, trupin e shtrirë në varr, që ngjalli Adamin fajtor. Eni shpejtoni si Magët t'i falemi, dhe t'i blatojmë myrra për dhurata të pështjellurit në prokof edhe jo në shpërgin, le ta qajmë dhe le t'i thërresim: Ngjallu, o Zot, që u fale Ngjalljen të rënëve.

SINAKSARI

Të Dielën e Shenjtë të Pashkës së Madhe kremtojmë Ngjalljen jetëprurëse të Zotit edhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jesu Krisht.

E ati është lavdia dhe fuqia në jetët e jetëve. Amin.

Pastaj thuhet për së treti:

Passi pamë Ngjalljen e Krishtit . . . **(3 herë)**

Kur u-ngrit Jesuj prej varrit. . . **(3 herë)**

KENGA VII.

Tre Djemat midis flagës i mproj me shi, dhe vetë u-bë njeri, dhe pësoj si ne, dhe me Pësimin shpëtimtar, na stolisi me jetën që nukë vdes, i vetëmi Perëndi i bekuar, i Atërve lavdi më ty. **(2 herë)**

Me myrra t' arthnë Gratë vajtonjëse, në varrin o Zoti Krisht; dhe me lot në sy të kërkonin si njeri, po të gjetnë me gas Perëndi dhe Zot, dhe Pashkën e re mi dhe, ua çpalln' Apostujve dhe besnikëve.

Kremtojmë se Skëterra përdhe u-shtri, vdekj' e zezë u-përmbys, dhe një jet' e re, e shenjtë pa mbarim po nis, dhe këcejm' e këndojmë çlironjesin, të vetëmin Perëndi të bekuar, të Atërve lavdi më ty.

Kjo ditë është e shenjtë shpëtonjëse, ditë lumëronjëse, ditë që na ndrit, se Pashka botën e gëzon, se ahere

u-ngjall i përjeçimi, Jesuj dhe Zoti Shpëtimtar, i vetëmi Perëndi i bekuar, i Atërve lavdi me ty.

ZBRITESORJA VII.

Tre Djemat midis flagës i mproj me shi

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. **(3 herë)**

Kur u-ngrit Jesuj prej varrit i tridiçim siç tha më parë, jetë na dhuroj, të pasosur dhe përdëllim të math.

Pastaj thuhet Litanja e Vogël:

DHJAKU. Përsëri dhe përsëri, më paqe le t'i lutemi Zotit. . . .

PRIFTI: Qoftë e bekuar dhe e lavdëruar madhështia e Mbretërisë sate, e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KENGA VIII.

Dita m' e shkëlqyer është Pashk' e Madhe, e para dit' e javës, që mbretëron mi të gjitha, panair dhe kremtim, i kremtimeve dhe i panaireve. Pra sot e bekojmë, për jetë Jesu Krishtin. **(2 herë)**

Eni të kungojmë me verën e hardhisë, të vreshtës së bekuar, të Perëndisë tonë, se Jesuj sot u-ngrit, dhe u hapi qjellin gjithë besnikëve. Pra sot e bekojmë, për jetë Jesu Krishtin.

Hidh-e syrin rrotull o breg i Sionës, shiko se ja ku vijnë, si yj të ndriçim besnikët, që në jug' e veri, dhe prej lindjes gjer në detin djemat e tu. Pra sot e bekojmë, për jetë Jesu Krishtin.

Ati i fuqishim o Bir o Shpirt' i Shenjtë, Trinia e pandarë, tre veta një natyrë, Zot i math Perëndi, që të gjith' u-pagëzuan mi emrin tënt. Pra sot e bekojmë, për jetë Jesu Krishtin.

ZBRITESORJA VIII.

Dita m' e shkëlqyer është Pashk' e Madhe. . . .

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. **(3 herë)**

Kur u-ngrit Jesuj prej varrit i tridiçim siç tha më parë, jetë na dhuroj, të pasosur lart në qjell dhe përdëllim të math.

Pastaj thuhet Litanja e Vogël:

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri, më paqe le t'i lutemi Zotit. . . .

PRIFTI: Se emri yt është i bekuar, dhe Mbretëria jote e lavdëruar, e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

DHJAKU: Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës, me hymne nderimi le ta madhështojmë.

KENGA IX

O shpirt madhështojë, Krishtin jetëdhënës, që vdiq dhe u-ambulua, dhe u-ngrit nga varri, si mundës i tridiçim.

Ndriçohu ndriçohu, qytet i ri Jerusalem, se lavdia e Zotit, përmi ty ka lindur sot. Valle këce, dhe gëzohu Sion, ti o Mari, Nën' e Perëndisë, dëfre për Ngjalljen e Birit tënt. **(2 herë)**

Krishti është Pashka, dhe therorja e shenjtë, dhe qengj' i Perëndisë, që ngre mëkatën e botës.

O zë fort i dashur, zë fort i ëmbël dhe gazmor, se me ne u-zotove, që të jesh o Zoti Krisht, gjer m' atë kohë kur bota merr funt; pra çdo besnik, shpresë ka për qjellin, të gjithë pra ngazëllohuni.

Sot krijes' e tërë, gëzohet ngazëllohet, u-ngjall nga varri Krishti, dhe Ferri u-dërmua.

O zë fort i dashur, zë fort i ëmbël dhe gazmor, se me ne u-zotove që të jesh o Zoti Krisht, gjer m' atë kohë kur bota merr funt; pra çdo besnik, shpresë ka për qjellin, të gjithë pra ngazëllohuni.

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë. O shpirt madhështojë, Perëndin' e vetëm, Trininë me tre veta, të Shenjt' e të pandarë.

O Pashka e Madhe, Pashka e Shenjt' o Zoti Krisht, Perëndi edhe Fjalë, urtësi edhe fuqi; shpjerna pra lart, në Parajs' e në qjell, ku mbretëron ti o Zot për jetë, mi fronin e gjithë botëve.

Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve Amin. Gëzohu Virgjëreshë, gëzohu e bekuar, dhe e lavdëruar, se Biri yt nga varri, u-ngjall si i pavdekur.

O Pashka e Madhe, Pashka e Shenjt' o Zoti Krisht, Perëndi edhe Fjalë, urtësi edhe fuqi; shpjerna pra lart, në Parajs' e në qjell, ku mbretëron ti o Zot për jetë, mi fronin e gjithë botëve.

ZBRITESORJA IX

Një Engjëll i thërriste, hirplotes pa pushuar: Gëzohu Virgjëreshë, dhe prapë të them Gëzohu, se Biri yt nga varri, u-ngjall të tretën ditë.

Ndriçohu ndriçohu, qytet i ri Jerusalem, se lavdia e Zotit, përmi ty ka lindur sot. Valle këce, dhe gëzohu Sion, ti o Mari, Nën' e Perëndisë, dëfre për Ngjalljen e Birit tënt.

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. **(3 herë)**

Kur u-ngrit Jesuj prej varrit i tridicim siç tha më parë, jetë na dhuroj, të pasosur dhe përdëllim të math.

Pastaj Litanja e Vogël:

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri.

PRIFTI. Se ty të këndojnë gjithë forcat e qjellit. . . .

DERGIMESORJA, T. II

SARKI IPNOSAS

Si fjete si njeri me trup, o Mbreti ynë Zoti Krisht, u-ngjalle të tretën ditë, dhe ngrite gjyshin Shën Adam, dhe e dërmovë vdekjen krejt. Pashkë burim i jetës, shpëtim i besnikëve. **(3 herë)**

LAVDERIMET, T. I.

Çdo frymë le ta lavdëronjë Zotin; lavdërojeni Zotin prej qiellit; lavdërojeni në më të lartat. Ty të ka hie kënga, o Perëndi.

Lavdërojeni gjithë Engjëjt' e tij; lavdërojeni gjithë Forcat e tij. Ty të ka hie kënga, o Perëndi.

Lavdërojeni për poterat e tij; lavdërojeni për shkëlqimin e madhërisë së tij.

Pësimin shpëtimtar, Jesu Krisht e hymnojmë, dhe e lavdërojmë Ngjalljen e tridicime.

Lavdërojeni me trumbetë, lavdërojeni me këngëtove dhe me gitarrë.

Ti o Zot që durove, Kryq dhe vdekje për njerëzinë, edhe u-ngjalle pas tri ditësh, paqësonaje jetën si i gjithë-fuqishim.

Lavdërojeni me kimbale dhe me valle; lavdërojeni me kordha e me strumenta.

E plaçkite Skëterrën, dhe njerinë e përsërite, me Ngjalljen tënde o Jesu, pra ti na vlerëso të të hymnojmë, me zëmer të ndriçime.

Lavdërojeni me kimbale tingëllonjëse; lavdërojeni me kimbale brohoritëse; çdo frymë le ta lavdëronjë Zotin.

Zbrite me lavdi si Perëndi, për hir të njerësve, o Krisht o Shpëtimtar, se linde prej Marisë, dhe s' u-ndave nga yt-Atë lart në qjell; vojte si njeri mi dhe, dhe u-ombertheve me dashje përmi Kryq, edhe u-ngjalle nga varri, dhe fluturove lart në qjell; dhe shpëtove tërë botën o Zot lavdi më ty.

Pastaj këndohen Lavdërimet e Pashkës, T. T. I:

Le të ngrihet Perëndia, dhe le të përndahen armiqtë e tij, dhe le të ikën prej faqes së tij ata që i kanë mëri.

Pashka e bekuar na ndriti dhe na shkëlqeu sot; Pashk' e shenjtë Pashk' e re; Pashka plot mister; Pashka e besnikëve; Pashka me Krishtin çlirimtar, Pashk' e ndriçime; Pashk' e madhe; Pashka për besnik; Pashka që çeli çdo derë të Parajsës për neve; Pashk' e Krishtit që bekon çdo besnik.

Do të humbasin si tymi në erë; do të shkrijnë si dylla përpara zjarrit.

Ejani prej pamjes o gra mirëlaajmëronjëse, edhe Sionës thojini, lajmën me gëzim prej nesh po mësojeni; luaj dhe këce, dhe gëzohu o Jerusalem, se Mbretin tonë Jesu, e pe të ngjallet prej së vdekurësh, me kurorë prej një dhëntëri.

Ashtu do të humbasin mëkatarët prej faqes së Perëndisë, dhe të drejtët do të dëfrenjë.

Gra myrëprurëse arthnë, pa u-gëdhirë, dhe qëndruan pranë varrit të Shpëtimtarit, gjetnë Engjëllin, i cili rrinte mi gur atje, dhe ay u-drejtua mi ato, dhe kështu u tha: Si kërkoni të gjallin me të vdekurit? Si vajtoni si të prishur të paprishurin? Shkoni lajmën shpjeruni Apostujve të tij.

Do është dita që ka bërë Zoti; le të ngazëllohemi dhe le të dëfrenjë n' atë.

Pashka që na çel; Pashka e Zotit Pashka; Pashka e nderuar na shkëlqeu sot mi dhe; Pashka me gëzim, pra eni të përshëndoshemi; o Pashkë që ndjek helmin. Se sot prej varrit pas tri ditësh, si prej nusërores ndriti Jesuj, dhe gratë i gëzoj dyke u thënë Lëçituni Apostujve.

LAVDI DHE TANI: Ardhi dit' e shenjt' e Ngjalljes, le të ndriçohemi prej panairit, dhe eni të përshëndoshemi; çpallim sot vllazëri, me sa na kanë mëri, le t'i ndjejmë të gjitha ditën e Ngjalljes, dhe le të thërresim sot: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. (**3 herë**)

Pastaj nis menjëherë Mesha e Shën Joan Gojartit:

DHJAKU: Beko, o Atë.

PRIFTI: E bekuar është Mbretëria e Atit edhe Birit

edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI Amin.

Pastaj Tropari i Pashkës tri herë, dhe Litanja e Madhe. Në Hyrjen këndohet Përlëshorja e Pashkës tri herë.

HYRTORJA

Nër Kishët e beconi Perëndinë, Zotin nga burim' i Israelit. Shpëto-na o i Bir i Perëndisë, që u-ngjalle së vdekurësh, ne që të këndojmë Alilluia.

SHKURTORJA

I KE EN TAFO KATILTHES

O i pavdekur që zbrite në varr për ne, dhe e dërmove Skëterrën o Zot përdhe, dhe u-ngjalle si fitimtar o Krisht Perëndi, edhe Grave me myrra u thirre Gëzohuni, dhe u dhurove paqen e qjellit dishepujve, ti që u fale Ngjalljen të rënëve.

Në vëndin e Hymnit Trishenjtor, thuhet:

OSI IS KHRISTON EVAPTISTHITE

Sa u-pagëzuat më Zotin Krisht, u-veshtë me Zotin Krisht, Alilluia.

APOSTULLI

DHJAKU: Le të vëmë re.

KENDONJESI: Kjo është dita që ka bërë Zoti; le të ngazëllohemi, dhe le të dëfnejmë n' atë.

DHJAKU: Urtësi.

KENDONJESI: Këndimi prej Akteve të Apostujve.

DHJAKU. Le të vëmë re.

KENDONJESI: Në shkresën e parë, o Theofil, kam folur për veprat, që bëri Jesuj, dhe për mësimet, që dha gjer në ditën që fluturoj në qjell, pasi u la Apostujve, që pati zgjedhur, porrosira me anën e Shpirtit të Shenjtë. Përpara këtyre u-fanes i gjallë pas Pësimeve me shumë shenja, dyke u-dukur përpara atyre për dyzet ditë dhe dyke u folur mi Mbretërinë e Perëndisë. Dhe një ditë, që ishin mbledhur, i porrositi të mos largohen nga Jerusalemi, po të presin zotimin e Atit, për të cilin ju kam folur. Se Joani pagëzoi me ujë, po ju do të pagëzoheni me Shpirtin e Shenjtë pas pakë ditësh që sot. Pra, kur ishin mbledhur, e pyesnin dhe i thoshin: "O Zot, a do ta ristorosh Mbretërinë e Israelit këtë herë?" Dhe ay u tha: "Nuk është puna juaj të dini kohët edhe motet, të cilat i ka në dorë Ati. Po do të merrni fuqi, kur të vinjë mi ju Shpirti i Shenjtë. Dhe do të dëshmoni për mua në Jerusalem dhe në tërë Judene, dhe Samarinë, dhe gjer në fund të dheut."

KORI: Alilluja, alilluja, alilluja.

DHJAKU: Urtësi, o të drejtë. Le ta dëgjojmë Ungjillin e Shenjtë.

PRIFTI: Paqe të gjithëve.

KORI: Dhe me frymën tënde.

DHJAKU: Këndimi prej Ungjillit të Shenjtë pas Joanit.

PRIFTI: Le të vëmë re.

UNGJILLI PAS JOANIT

DHJAKU: Në krye ishte Fjala, dhe Fjala ishte me

Perëndinë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ky ishte në krye me Perëndinë, dhe të gjitha u-bënë me anën a tij, dhe pa atë nuk u-bë asnjë kriesë. Ay kishte jetë; dhe jeta ishte drita e njerësve. Ishte një njeri, i dërguar nga Perëndia, i cili quhej Joan. Ky ardhi që të dëshmonte për Dritën, që të besonin të gjithë me anën e tij. Ay nuk ishte Drita, po vetëm dëshmonte për Dritën, për Dritën e vërtetë, që ndrit të gjithë njerëzit që vijnë në botë. Ardhi në botë, dhe bota u-bë me anën e tij, po bota nuk e njohu. Ardhi në njerëzit e tij, po njerëzit e tij nuk e pritën. Po atyre, të cilët e pritën dhe besuan më emrin e tij, u dha fuqi të bëhen bij të Perëndisë, të cilët nukë lintnë nga gjaku dhe nga trupi prindëror po nga Perëndia vetë. Edhe Fjala u-mishërua, dhe banoj në mes tonë, dhe e pamë lavdinë e tij, si lavdi të Birit të vetëmlindur të Perëndisë, plot me hir e me të vërtetë. Joani dëshmoj për atë, dhe thirri, dyke thënë: “Ay që vjen pas meje është më i math së unë, se ishte përpara meje.” Dhe nga plotësia e tij kemi marrë të gjithë ne, dhe hir për hir. Se ligja u-dha prej Moisiut, po hiri dhe e vërteta arthnë prej Jesu Krishtit.

Në “Veçan Tërëshenjtën”, këndohet Zbritësorja IX:

O ANGELLOS EVOA T. T. I

Një Engjëll i thërriste, hirplotes pa pushuar: Gezohu Virgjëreshë, dhe prapë të them Gezohu, se Biri yt nga varri, u-ngjall të tretën ditë.

Ndriçohu ndriçohu, qytet i ri Jerusalem, se lavdia e Zotit, përmi ty ka lindur sot. Valle këce, dhe gezohu Sion, ti o Mari, Nen' e Perëndisë, dëfre për Ngjalljen e Birit tënt.

KUNGATORJA

Trupin e Krishtit e kungoni, burimin e pavdekur

e ngjëroni, Alilluia, alilluia, alilluia.

Në vënt të “Pamë Dritën” edhe “Emri i Zotit”, këndohet Përlëshorja e Pashkës. Pas Uratës perpara Tribunës këndohet Urata e Pashkës prej Shën Joan Gojartit. (Shiko Uratoren f. 519-521). Pastaj menjëherë këndohen:

PERLESHORJA E SHEN JOAN GOJARTIT, T.T.IV.

I TU STOMATOS SU

Fjala jote si një pishtar, shkëlqeu dhe ndriti, botën e tërë me dituri; thesaret e varfërisë na dhuroj, dhe lartësinë e përunjesisë na tregoj. Po siç na rrite me fjalë, Atë Shën Joan Gojartë, lutju Krishtit Fjalës Perëndi, të shpëtohen shpirtet tona.

PERLESHIMI

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. (3 herë pa zë)

Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, që u-ngjall së vdekurësh, me nërmjetimet e Shën Marisë dhe të gjithë Shenjtorëve, na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si i mirë dhe njeridashës.

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. (3 herë pa ze)

MBREMESORJA E PASHKES

Përpara drekës Priftërinjtë vishen me robat më të mira dhe shetitën në fshatin a në qytetin, dyke kënduar ngadale Përlëshoren e Pashkës. Pastaj këthehen në Kishë, Prifti temjanis Alltarin, dhe nis Mbrëmësoren:

PRIFTI: Lavdi Trinisë së bashkëqënshime, jetëbërëse, dhe së pandarë, gjithënjë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

Pastaj këndohet Tropari i Pashkës me Vargjet si në Ngjalljen e Parë, pastaj Litania e Madhe dhe Thirrtoret:

THIRRTORET, T. II.

Ty o Zot, të thirra në mëngjes; dëgjo-ma lutjen, dëgjo-ma lutjen, shpejt o Zot. Ty o Zot, të thirra në mëngjes; dëgjo-ma lutjen, ver-i veshin zërit të lutjes sime. Ja ku të thërres që në mëngjes; dëgjo-ma lutjen, shpejt o Zot.

Le të drejtohet posi temjani, lutja ime sot, përpara teje; duart' i ngre përpjetë, për mbrëmë si për kurban; dëgjo-ma lutjen, shpejt o Zot.

Po t'i vësh re paudhësitë, kush munt të qëndronjë përpara teje, o Zot. Po pranë teje është ndjesa.

Ejani t' adhurojmë Fjalën e Perëndisë, që lindi prej Atit përpara jetëve, dhe u-mishërua prej Marisë Hyjllindëse, se duroj kryqësimin dhe varrimin me dashje, dhe u-ngjall së vdekurësh, dhe e shpëtoj njerin' e arratisur.

Jam dyke pritur Zotin, dhe shpirti im ka shpresë në fjalën e tij.

Shpëtimtari Jesu Krisht, e mbërtheu dhe e shojt,

dënimin tonë përmi Kryqin, dhe e dërmoj fuqin' e vdekjes; ejani pra t' adhurojmë, Ngjalljen e tij të triditë.

Që në mëngjes gjer mbrëmë le të shpërenjë Israeli më Zotin.

Tok me Krye-ëngjëjtë, le ta hymonjmë Ngjalljen e Zotit Krisht, se ay është çlironjësi, dhe Shpëtimtari i shpirtëve tona, dhe do të vinjë prapë me lavdi, dhe me fuqi të tmerruar, për të gjykuar botën që krijoi.

Se Zoti ka mëshirë, dhe ay do ta çpërblenjë Israelin nga të gjitha paudhësitë.

Ty që u-kryqësove dhe u-varrose, Engjëlli të lëçiti sot, edhe u thoshte Grave. Eni dhe shihni ku dergjej Zoti, se u-ngjall sikundër tha, si i gjithëfuqishim; pra të adhurojmë, o i vetëm, i pavdekur dhe jetëdhënës, kij mëshirë për ne o Krisht.

Lavdërojeni Zotin gjithë kombet; lavdërojeni gjithë popujtë.

E abolite me Kryqin tënt, mallkimin e drurit, dhe e dërmove me varrimin tënt, fuqin' e vdekjes, dhe me Ngjalljen e triditë, e ndriçove gjindjen njerëzore, përandaj pra të thërresim: Mirëbërës Jesu Krisht, o Zot lavdi më ty.

Se ka patur mëshirë të madhe për ne, dhe e vërteta e Zotit mbretëron për jetë.

T' u-hapnë o Zoti Krisht, nga frika dyert' e vdekjes dhe portarët e Skëtërrës, u-tmerruan kur të panë, se i dërmove portat e kipërta, dhe i theve llozet e hekurta, dhe na nxore nga errësira, dhe nga hija e vdekjes, dhe na i çkepute vargonjtë.

LAVDI. Po këndojmë hymnin shpëtimtar, dhe thërresim me zë të math. Ejani në shtëpinë e Zotit, t'i

themi mëgjunjazi: Ti që u-kryqësove mi Kryq, edhe u-
ngjalle pas tri ditsh, dhe je në gjirin atëror, dhurona
ndjesën e mëkatave.

TANI. Ka shkuar errësir' e Ligjes, se ardhi hiri
dhe mëshira, se posi ferra që s' po digjej nga zjarri dhe
nga flaga, linde e virgjër Zotin Krisht, mbete e virgjër
dhe pastaj; si kollonë me zjarr, na lindi Dielli i drejtësi-
së, dhe si Moisiu Jesuj, qe i shpëtoj të gjithë njerëzit.

*Pastaj bëhet Hyrja e Vogël me Ungjillin: Dhjaku përpara
dhe Prifti pas, dalin nga dera e veriut, qëndrojnë përpara Derës
së Bukur, dhe Prifti bekon Hyrjen. Pastaj Dhjaku ia jep
Priftit Ungjillin që ta përshëndoshë, shkon përpara Priftit, edhe
thotë me zë të lartë:*

DHJAKU: Urtësi, o të drejtë.

*Prifti dhe Dhjaku hyjnë brënda në Shenjtëroren, dhe
Dhjaku temjanis Alltarin; Kori këndon:*

KORI: Dritë gazmore e lavdisë qjellore, Jesu
Krisht, si arrimë perëndimin e diellit, edhe pamë dritën
e mbrëmës, hymnojmë Atin e Birin edhe Shpirtin Shenjt,
se të ka hie kënga kurdoherë o i Bir i Perëndisë që fal
jetën, përandaj të lavdëron e tërë bota.

Pastaj Dhjaku thotë me zë të lartë:

DHJAKU. Parëvargu i mbrëmës.

KORI: Cili vall' është, i math sa ti o Zot. Ti vetëm
bën çudi, o Perëndia ynë. (3 herë)

PRIFTI: Dhe që të vlerësohemi ta dëgjojmë,
Ungjillin e Shenjtë, Zotit Perëndisë tonë t'i lutemi.

KORI: Mëshiro, o Zot. (3 herë)

*Pastaj këndohet Ungjilli në gjuhë të ndryshme, i ndarë në
tri pjesa:*

DHJAKU: Urtësi o të drejtë. Le ta dëgjojmë Un-
gjillin e Shenjtë.

PRIFTI: Paqe të gjithëve.

KORI: Dhe me frymën tënde.

PRIFTI: Këndimi prej Ungjillit të Shenjtë pas
Joanit.

DHJAKU: Le të vemë re.

UNGJILLI PAS JOANIT

Passi u-ngrys atë ditë, e cila ishte e para e javës,
edhe kur ishin dyertë të mbyllura atje, ku qenë mbledhur
disheputjë nga frika e Judenjve, ardhi Jesuj, edhe qënd-
roj në mest, edhe u tha: "Paqe më ju." Edhe passi u tha
këto fjalë, u dëfteu duartë dhe brinjën e vetë. Edhe
disheputjë u-gëzuan, kur e panë Zotin.

Pastaj Jesuj u tha përsëri: "Paqe më ju. Sikundër
më ka dërguar mua Ati, ashtu edhe unë ju dërgonj ju." Edhe
passi u tha këto fjalë, u fryri dhe u tha: "Merreni
Shpirtin e Shenjtë. Kujve tua falni mëkatat, u janë falur;
kujve tua mbani, u janë mbajtur."

Po Thomaj, një prej të dymbëdhjetëve, i cili quhej
Binjak, nuk ishte me ata, kur ardhi Jesuj. Disheputjë
e tjerë, pra, i thoshnin: "E pamë Zotin." Po ay u tha:
"Në mos pafsha shenjat e peronave në duartë e tij, dhe
në mos vënça gishtin në shenjat e peronave, dhe në mos
e vënça dorën në brinjën e tij, nukë do ta besonj."

KORI: Lavdi më ty, o Zot, lavdi më ty.

Pastaj Litanja e Gjërë, Vlerësona, dhe Litanja e Gjatë.

PASVARGJET

T. II. Ngjallja jote, o Shpëtimtar Jesu, ndriti tërë botën dhe tërë krijesën, dhe e ndolli prapë njerin' e mjerë. Zot i Forcave lavdi më ty.

Pastaj Vargëzimet e Pashkës, Lavdia e Pashkës dhe Përlëshimi i Pashkës.